



Në bazë të nenit 19 të Ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës Nr. 2004/7, nenit 27 të Statutit të Odës Ekonomike të Kosovës, Kryetari i OEK shpallë këtë:

FTESË PUBLIKE PËR ANGAZHIMIN E SHËRBIMEVE PROFESIONALE PËR VLERËSIMIN DHE CERTIFIKIMIN E KOMPANIVE PJESMARRËSE NË SISTEMIN E ARSIMIT DUAL

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), në kuadër të projektit “Shkathtësitë për punësim të qëndrueshëm në Kosovë”, të financuar nga Qeveria e Luksemburgut dhe zbatuar nga LuxDev, Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor, shpall thirrje publike për angazhimin e një kompanie konsulente ose ekspertësh individualë në fushën e Arsimit dhe Aftësimin Profesional (AAP), me fokus të veçantë në **Arsimin Dual**.

Shërbimet përfshijnë:

- Shqyrtimin e kriterëve dhe standardeve të certifikimit
- Hartimin/finalizimin e metodologjisë dhe instrumenteve të vlerësimit
- Përmeshjen e vizitave në terren në kompanitë aplikuese
- Vlerësimin e kapaciteteve të kompanive për implementimin e Dual VET
- Verifikimin e pajtueshmërisë me kriteret e përcaktuara
- Intervistimin e përfaqësuesve të kompanive dhe verifikimin e dokumentacionit
- Përgatitjen e raporteve të vlerësimit
- Ofrimin e rekomandimeve për kompanitë që plotësojnë kushtet për certifikim

Fushëveprimi i angazhimit:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Përgatitja dhe definimi i metodologjisë	Ditë pune	Sipas planit të punës
2	Përpilimi i raportit të analizës së standardeve	Ditë pune	Sipas planit të punës
3	Krijimi i paketës së instrumenteve të vlerësimit	Ditë pune	Sipas planit të punës
4	Prezantimi dhe shqyrtimi i kriterëve dhe standardeve të certifikimit	Ditë pune	Sipas planit të punës
5	Implementimi dhe punë në terren	Ditë pune	Sipas planit të punës
6	Krijim i kalendarit për vizita tek bizneset	Ditë pune	Sipas planit të punës
7	Te dhënat lidhur me verifikimin nëpër biznese	Copë	1
8	Raporti i vlerësimit të kapaciteteve	Copë	1
9	Raport i pajtueshmërisë	Copë	1
10	Regjistri i Rekomandimeve për Certifikim	Copë	1
11	Raporti përmbledhës i Procesit:	Copë	1

Dokumentet që duhet të dorëzohen nga kompania/konsulenti

- Së paku një kontratë/referencë gjatë pesë viteve të fundit lidhur me arsimin dhe aftësimin profesional në përgjithësi ose aktivitet lidhur me promovimin e arsimit dual.
- Paraqitja e një propozimi teknik që përfshin metodologjinë paraprake për arritjen e objektivave të angazhimit
- Paraqitja e propozimit financiar/buxhetit për shërbimet e propozuara,

- Paraqitja e listës së një ekipi prej së paku dy (2) ekspertësh për realizimin e kësaj detyre, përfshirë një Menaxher Projekti/Ekspert të AAP-së si ekspert kyç me përvojë në sektorin e AAP-së, veçanërisht në arsimin dual.

Kërkesat për Ekspertin 1 – Menaxher Projekti

- CV profesionale;
- Diplomë universitare master në fushë relevante.
- Minimum 5 vite përvojë profesionale në menaxhim duke përfshirë AAP-në
- Njohuri mbi sistemin Dual VET (përparësi);
- Aftësi profesionale në hartimin e dokumentave teknike dhe procese konsultative;
- Përvojën në bashkëpunim me institucione publike, kompani dhe palët e interesit.
- Minimum 1 referencë relevante ose dëshmi relevante.

Kërkesat për Ekspertin 2 – Ekspert i AAP-së

- CV profesionale;
- Diplomë universitare master në fushë relevante.
- Minimum 5 vite përvojë profesionale në projekte të natyrës dhe përmasës së ngjashme dhe me fokus në Arsimin Dual
- Përvojën në bashkëpunim me institucione publike, kompani dhe palët e interesit
- Minimum 1 referencë relevante ose dëshmi relevante.

Raportimi:

Eksperti duhet të punojë me koordinim të ngushtë me OEK/ Qendrën për Arsim Dual dhe do ti raportoj menaxherit të projektit.

Ftesa publikohet në uebfaqen zyrtare dhe në Facebook-un e Odës Ekonomike të Kosovës.

Kriteri i përzgjedhjes së ofertës fituese:

1. Propozimi teknik 70 %: Metodologjia, Kualifikimi, CV dhe përvoja, referenca
2. Propozimi Financiar 30 % **çmimi më i volitshëm i ofertuar**, duke marrë parasysh përmbushjen e kërkesave teknike dhe profesionale.

Ofruesi i shërbimit duhet ta ketë parasysh ky aktivitet do të zbatohet deri në mes të muajit **Qershor 2026**, ndërsa cmimi total duhet të mbulojë të gjitha shërbimet e kërkuara për realizimin e aktivitetit A.1.4.2 -Vlerësimi i kompanive pjesëmarrëse në Arsim Dual, për të gjitha fazat e planifikuara deri në përfundim të projektit, pa kosto shtesë për OEK-un.

Aktiviteti synon të mbështesë zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të certifikimit për kompanitë e përfshira në sistemin Dual VET, të rrisë cilësinë institucionale të procesit të certifikimit dhe të sigurojë standardizim, transparencë dhe qëndrueshmëri në zbatimin e sistemit.

Vlera totale e parashikuar: 10,000 EUR (PA TVSH).

Dokumentet duhet të dërgohen në email: arsimidual@oek-kcc.org, duke shënuar në subjekt: "Ofertë për ftesë publike –Vlerësimi dhe Certifikimi i kompanive pjesëmarrëse në Arsim Dual", më së largu deri më 05.05.2026, ora 14:00.

Ky aktivitet realizohet me mbështetjen e projektit "Shkathhtësitë për punësim të qëndrueshëm në Kosovë", financuar nga Qeveria e Luksemburgut dhe implementuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, dhe LuxDev, Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor.

Lulzim Rafuna

Kryetar

Oda Ekonomike e Kosovës

